



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS S.H.A.
NJËSIA AUDITIT TË BRENDSHËM

Nr. 1974/ Prot.
6

Durrës, më 23.10.2023

Drejtuar: **Departamenti Teknik**
Drejtoria Planifikim Menaxhim Aseteve
Drejtoria Prodhim Transmetim Uji
Drejtoria Shpërndarjes së Ujit
Drejtoria Mirëmbajtjes
Drejtoria Grumbullimit të Ujit
Drejtoria Trajtimit UJ

Lënda: Raporti-Përfundimtar

Në mbështetje të gërmeës "a" të nenit 14 të Ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015, "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", të ndryshuar me Ligjin nr.12/2023, datë 02.02.2023, si dhe në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit të Brendshëm, dhe në përputhje me Planin Vjetar të Auditimit për vitin 2025, të miratuar nga Administratori i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a, z. Jug. Seadi Çausi, me shikresën Nr. 5369/2 prot., datë 11.10.2024, dhe të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin nr.11, të përcjellur bashkëlidhur, Raportin e Auditimit të Brendshëm me temalikë: "Auditim i veprimtarisë në Departamentin Teknik dhe në Drejtoritë në varësi. Vlerësimi i njafueshmërisë dhe efektivitetit të menaxhimit, zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut për sistemet/fushat/proceset që zbatohen në këtë Departament" për periudhën 01.01.2024-31.12.2024"

Në mbështetje të nenit 14 të Ligjit 114, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr.42, datë 27.10.2020, brenda afatit ligjor 30 ditë duhet të na iletëgjori prapë Njësisë së Auditimit, planin veprimtar për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në këtë raport final

Si fjalëmbledhje për bashkëpunimin!

Njësia Auditit të Brendshëm



**UJËSJELLËS
KANALIZIME**
RAJONI DURRËS

Adresa: L.17.8 - Dalip Përra www.ujkdurres.al e-mail: info@ujkdurres.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSIELLËS KANALIZIME Durrës SILA
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORT I ANGAZHIMIT TË AUDITIMIT

"Auditimi i veprimtarisë në Departamentin Teknik dhe në Drejtorinë në varësi, Vlerësimi i aftësisë dhe efektivitetit të menaxhimit, zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut për sistemet/fushat/proceset që zbatohen në këtë Departament".

Në zbatim të planit të Auditimeve për vitin 2025, të miratuar nga Administratoz i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime sh. a Durrës, Ing. Sedi Çuashi, me Nr. 5369/2 prot. dt.31.10.2024, të miratuar me Vendim Nr 13, të Këshillit Mbikqyrës, Njësia e Auditimit të Brendshëm do të angazhohet në një mision auditimi në Departamentin Teknik dhe Drejtorinë në varësi.

Objekti i Auditimit: Auditimi i veprimtarisë në Departamentin Teknik dhe në Drejtorinë në varësi, Vlerësimi i aftësisë dhe efektivitetit të menaxhimit, zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut për sistemet/fushat/proceset që zbatohen në këtë Departament.

Suhjekt Auditimi : Departamenti Teknik,
Drejtoria Planifikim, Menaxhim Aseteve
Drejtoria Prodhim Transmetim Ujë
Drejtoria Shpërndarjes së Ujit
Drejtoria Mirëmbajtjes
Drejtoria Qirumbullimit të Ujit
Drejtoria Trajtimit të Ujit



Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit është të vlerësojë aftësitë dhe efektivitetin e:

- Menaxhimit dhe strukturës organizative të Departamentit Teknik dhe njërive vartëse.
- Zbatimit të legjislationit dhe rregulloreve të brendshme.
- Funkcionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Sistemit të menaxhimit të riskut, identifikimit dhe parandalimit të rreziqeve potenciale operacionale
- Proqesore dhe procedurave të rrike dhe administrative që zbatohen nga ky departament.

Lloji i Auditimit: Auditim i rregullshmërisë dhe performancës (kombinuar)

Metoda e Auditimit: Auditim i plotë

Grupi i Auditimit: Znj. Fatmire Ballgjinj, Drejtuese grupi

Znj. Anisa Abnetaj, specialiste

Shënim/Për arsye shëndetësore specialisti Auditimit nuk ka marrë pjesë në vazhdimin e auditimit

Urdhëri për Auditim: Auditimi është programuar në Programin Vjetor të Auditimit.

Periudha e auditimit: Auditimi do të kryhet për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024

Afati i Auditimit: Auditimi do të lillojë në datën 14.04.2025 dhe do të përfundojë brenda datës 15.05.2025.



**UJËSIJELLËS
KANALIZIME
RAIONI DURRËS**

Adresa: L. 17. Kr. Da Ip Përa

e-mail: info@shrukd@ukdurrës.al

Telefoni: 037 200 10 00 / 037 200 10 01 / 037 200 10 02 / 037 200 10 03 / 037 200 10 04

Uaza ligjore:

- Ligji nr. 114, datë 22.10.2015, "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", i ndryshuar me Ligjin nr. 12, datë 02.02.2023, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015.
Manual i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"
- Karta e Auditimit të Brendshëm Publik dhe Kodi Etik për Audituesit e Brendshëm të Shoqërisë Rajonale UKD sh.a.
- Manuali për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar,
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për organizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotur"
- Vendimi nr. 1304, datë 14.02.2009, "Për furnizimin me ujë dhe kanalizime në zonën e shërbimit të Ujësjellës-Kanalizimeve" Vendimi nr 1304, dt. 14.02.2009 "Për furnizimin me ujë dhe kanalizime në zonën e shërbimit të Ujësjellës-Kanalizimeve",
- Ligji nr. 10137, datë 11.05.2009, "Për disa ndryshime në legjislacionin, në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile"
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"
- Rregulloja dhe struktura e funksionimit të Shoqërisë UKD sh.a, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore ose nënligjore që lidhet me aktivitetin e shoqërisë dhe misionit të auditimit.

Fusha dhe drejtëmet e auditimit:

- Strukturën organizative dhe funksionale të Departamentit Teknik.
- Planifikimin dhe zbatimin e projekteve teknike.
- Zbatimin e akteve ligjore dhe rregullatore përkonjese.
- Sistemet e monitorimit dhe raportimit të performancës.
- Propozimet për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe teknike.
- Administrimin e pasurive dhe kontratave teknike.



**UJËSJELLËS
KANALIZIME**
RAJON DURRËS

Adresa: 17 Bt. Dalgë, Pezë e-mail: info@shrukt@ukdurrës.sh

Metodologjia dhe teknikat e auditimit:

- Analizë dokumentacionale (regullore, vendtresa, ngritur teknike, kontrata, etj.)
- Intervista me drejtues dhe punonjës të Departamentit Teknik dhe njësive vartëse.
- Vlerësim i sistemeve të brendshme të kontrollit
- Analizë e rrisht dhe mënyrës së menaxhimit të tij

1. Hyrje

1.1 Përmbledhje Ekzekutive

- Rekomandime të tjera nga Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë auditimeve të kryera gjatë viti 2024.

Departamenti Teknik dhe drejtoritë në varësi janë audituar në mënyrë të pjesësime

1- Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit të Aseteve pranë Departamentit Teknik.

Pikat e lidhjes

Me shkresë nr. 2157 prot. dt 20.05 2024 dhe nga intervistimi i punonjësve në sektorin përkatës, vëhet re se: pasi një kërkesë për lidhjen uqit , verifikohet terreti me anë të lexuesit dhe miratohet preventivi për pikën e lidhjes

Gjetje 1: Nga auditimi vëhet re se nuk ka një proces verbal ose një dokumentim të ketyre detyrave si për sh. sa u bërguan në Drejtorinë e Shitjes, sa prej ketyre paguara, sa hapën kontratën dhe sa prej tyre u fitën në futurim nëpërmjet matësit të instaluar, çdo ditë vjen një raport nga kjo zyre, nga specialisti përkatës, por nuk vërehet bashkëveprim me Drejtorinë e Shitjes për të raportuar e konkluduar gjendjen

Rekomandim 1: Për efekt të rritjes së Kontrollit të Brendshëm duhet të rrucet bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Shitjes dhe të Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit të Aseteve (pikat e lidhjes, për të ngritur ciklin, aplikimin, pikat lidhje kontratë. Mbyllja e këtij ciklit është i rëndësishëm pasi bashkëveprimi bëu të mundur që kërkesa që vjen në sportel të finalizohet me një klient të shtuar në sistem dhe azhurnimin e tij në hartë nga Drejtoria Teknikë

Menjeherë



**UJËSJELLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresat, 17. Nr. Dalip Pasa

e-mail: info@shukid@ukdurrës.al

Duhet te vete një përgjigje me mënyrën se si ka gjëtur zbatim ky rekomandim.

Duke marrë parasysh se gjatë periudhës pas auditimit ka pasur **ndryshime strukturore në drejtim** aktualisht është në proces riorganizimi dhe riformatimi i praktikave të punës në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me **Drejtorinë e Shërbimit**, për të siguruar një vjedhje të unifikuar të informacionit dhe koordinim më të mirë ndër-institucional. Përmirësimi i gjurmueshmërisë dhe ciklit të dokumentacionit është identifikuar si prioritet dhe vete në fokus të bashkëpunimeve aktuale ndërdrejtore.

Gjetje 2: Grupi i auditimit nga intervistat tregoi se nuk përdoret në vendosja e matësve të bilancit në hyrje të objekteve të mëdha siç mund të jenë: parqe, resorte, komplekse banimi etj.

Rekomandim 2: Për efekt të uljes së marzhit të gabimit në përllogaritjen e nivelit të humbjeve dhe përmirësimit të treguesve që përbejnë bilancin e apt del e nevojshme dhe vendosja e matësve të bilancit në hyrje të objekteve të mëdha siç mund të jenë: parqe, resorte, komplekse banimi etj. Te fitet në projekte të kësaj zyre vëmendja e matësve të bilancit të nji, pasi tjetër si dëmshpërblimi në gjetjen dhe eliminimin e humbjeve të dukshme.

Duhet te vete një përgjigje me mënyrën se si ka gjëtur zbatim ky rekomandim.

Jdhe për këtë çështje për shkak të ndryshimit të stafit drejtues dhe strukturës teknike, implementimi i rekomandimit është në fazë diskutimi teknik dhe harmonizimi me projektet ekzistuese. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Shërbimit është intensifikuar për identifikimin e objekteve me prioritet të lartë, ku do të përbotohet fillimisht vendosja e matësve të bilancit. Përvashkohet që kjo të jetë pjesë e projektit të planit investues për tremujorin e tretë të vitit 2023.

• Konstatime kryesore dhe vlerësime

Duke u nisur nga dokumentacioni i kërkimit NJA konstaton se:

1. Departamenti Teknik

- ✓ Cilat janë projektet e furnizimit me ujë dhe plani investimor për furnizim (me fondë buxhetore apo vetëfinaancim si dhe hartimin e projektit preventivave përkatëse)
- ✓ Planin vjetorimor të veprimtarisë së Departamenti Teknik. A është miratuar paraprakisht tek Administratori i Shërbimit, si i parajtet për një raport mbi realizimin e planit, shembull (1 muaj)
- ✓ Analiza së departamenti plani buxhet.



**UJËSJETLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresa | 17.07 Dullip Peka | e-mail: info@ujkd@ujkurrres.al

- ✓ Regjistri i riskut si Departament
- ✓ Kontrolli i brendshëm si Departament (i ndarë në Drejtari dhe Sektorë)

Nga intervistimi NIA konstaton se:

Departamenti Teknik ka në proces zbatimin dhe planifikimin e disa projekteve për përmirësimin dhe zgjerimin e rrjetit të furnizimit me ujë.

Për çdo projekt është hartuar një projekt preventiv teknik dhe financiar, ku janë përcaktuar kostot e materialeve, kostot e punës, afatet e zbatimit dhe impakti në sistemin e afërsjellësit.

Nga intervistimi NIA konstaton se:

Departamenti harton në fillim të çdo viti një plan vjetor pune, i ndarë në pjesë në plane mujore, të cilat detajojnë:

- Zbatimin e projekteve të infrastrukturës
- Kontrollin teknik dhe mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues
- Monitorimin e cilësisë së furnizimit me ujë
- Departamenti Teknik përgatit një plan buxhetor vjetor, që përshfaq:
 - Shpenzimet operative dhe ato kapitale
 - Kostot e mirëmbajtjes së rrjetit
 - Investimet në pajisje dhe teknologji.

Bazuar në Udhëzimet e Brendshme nr. 34, datë 26.02.2025, ka nisur punën për hartimin e Regjistrit të Riskut për Departamentin Teknik.

Departamenti Teknik ka kërkuar koordinim mes të gjitha Drejtorive që ka në varësi, me qëllim funksionimin e Kontrollit të Brendshëm për vlerësimin dhe verifikimin e proceseve

I. Drejtorja e Planifikimit dhe Menaxhimit të Aseteve

- ✓ Rregullare e brendshme e funksionimit të Drejtorisë dhe përshtatja e çdo pozicioni pune.
- ✓ Hartimin e Regjistrit të Riskut dhe hapat që po ndiqen për të.
- ✓ Hartimin e Planëve të Kontrollit të Brendshëm dhe zbatimin i tyre, Analiza plan buxhetit.
- ✓ Raportimet javore-mujore dhe mosat e marra për anëtarët të konstatuara



**UJËSIELLËS
KANALIZIME
RAIONI DURRËS**

Adresa: P.L. Nr. Dalip Peza e-mail: info@shkrd@ukdurres.al

Sektori i Projektimit dhe Planifikimit Strategjik

- ✓ Plan mujor, vjetor, krahasuar me buxherin
- ✓ Hartimin e projekti buxhetit të analizës së çmimeve dhe miratimi i tij
- ✓ Kontrolli Brendshëm
- ✓ Regjistri Riskut

Sektori i Menaxhimit të Aseteve

- ✓ Plan mujor vjetor, për azhurmimet në Nisq të Kuvajet, Kuvjet dhe Rregullime
- ✓ Leuria e pikave lidhjes, raportimi me Drejtorinë Shitje (Mirëmbajtje) (Funksionaleti i matësve qëndror në godinat shumë katëshe dhe resortet) përcjellura që ndihet ku bazohet.

Drejtoria operon në bazën e rregullores së brendshme të Shqipërisë, e cila përcakton qartë detyrat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit për çdo pozicion pune.

Në vijim të Udhës të Brendshme nr. 34, datë 26.02.2025, Drejtoria ka filluar punën për hartimin e këtij regjistri për vitin 2025.

Drejtoria dorëzon raportime çdo javë dhe çdo muaj pranë Administratorit.

Sektori i Projektimit dhe Planifikimit Strategjik

Sektori harton çdo 3 muaj një projekt-buletin të analizës së çmimeve, duke rbledhur të dhëna nga tregu, kontratat në fuqi dhe buletinet e zyrtare teknike. Dokumenti i propozohet Drejtorisë për miratim.

Sektori i Menaxhimit të Aseteve

Leuria e pikave të lidhjes – Raportimi me Drejtorinë e Shitjes dhe Mirëmbajtjes
Funksionaleti i matësve në ndërtesa të mëdha shumëkatëshe dhe resorte është një prioritet kyq.

Edhe pse nuk është marrë një përgjigje e plotë zyrtare nga ky sektor por bazuar në intervista me stafin, është konstatuar që:

- Propozet janë në zbatim të planit të miratuar
- Raportimi me njësitë tjera është në çelës pozitive
- Është nevojshur thellimi i bashkëpunimit për evidentimin më të plotë të matësve dhe azhurmimit të regjistrit të aseteve në mënyrë të digjitalizuar.



2. Drejtoria e Prodimit dhe Transmetimit të Ujit

- ✓ Rregullora e brendshme e funksionimit të Drejtorisë dhe përshkrimi e çdo pozicioni pune dhe një përshkrim të shkurtër të pozicioneve të punës, bazuar mbi rregulloren e shërbimit)

Sipas Emailit dt 14.04.2025 nga Drejtoria Prodimit Transmetimit të Ujit ka ardhur Rregullorja dhe pozicionet e punës. NIA konstatim se këto pozicione në vijë të përgjithshme janë në përshkrim me Rregulloren dhe PSO-të përkatëse. Nga analiza e dokumentacionit dhe intervistimi i stafit, NIA konstaton se në disa raste mungojnë urdhërat e brendshëm të shkruar për fikjen e pompave në rast avarie apo gjatë riparimit të difekteve. Autorizimet në këto raste janë dhënë verbalisht dhe nuk dokumentohen në mënyrë të rregullt, gjë që bie ndesh me parimet e kontrollit të brendshëm dhe gjatmueshmërisë së veprimeve operative.

<p>Numri i Gjetjes Nr.1 Subjekti Audituar Njësia/Subjektet e Interesuara</p>	<p>Departamenti Teknik/DPTU D.P.T.U</p>
<p>Përshkrimi i Gjetjes nr 1</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit dhe intervistimi i stafit, NIA konstaton se në disa raste mungojnë urdhërat e brendshëm të shkruar për fikjen e pompave në rast avarie apo gjatë riparimit të difekteve. Autorizimet në këto raste janë dhënë verbalisht dhe nuk dokumentohen në mënyrë të rregullt, gjë që bie ndesh me parimet e kontrollit të brendshëm dhe gjatmueshmërisë së veprimeve operative.</p>
<p>Situata</p>	<p>Praktiza aktuale e autorizimit për fikjen e pompave në raste të veçanta kryhet në mënyrë verbale pa mbështetje dokumentare (urdhër të brendshëm), gjë që e bën të vështirë gjurmimin dhe verifikimin e veprimeve të kryera</p>
<p>Kriteri</p>	<p>Sipas Rregullores dhe Procedurave Standarde të Operimit (PSO), çdo veprim që ndikon në funksionimin e pajisjeve teknike duhet të shoqërohet me dokumentacion përkatës, përshkrim urdhëra e brendshëm të miratuar nga autoriteti përgjegjës.</p>
<p>Ndikimi/Efekti</p>	<p>Mungesa e dokumentimit të veprimeve teknike mund të çojë në:</p>



- Vështirësi në analizën e situatave problematike
- Rrethje të rrisht për gabime teknike dhe operacionale
- Mungesë përgjegjësie të çartë në rast mospërfundimit të punës

Niveli Vlerësimit të Riskut

Konkluzioni

Rekomandimi 1

Afati Fundit për zbatimin e Rekomandimit
Statusi i Rekomandimit

Udhëzimet

Praktikat aktuale nuk janë në përputhje të plotë me kërkesat për dokumentim dhe kontroll të veprimeve operative, çka ndikon negativisht në transparencën dhe sigurinë e proceseve teknike të implementohet menjëherë një praktikë e detyrueshme për lëshimin e urdhërave të brendshëm të dokumentuar për çdo rast të Ekjes së pompave për arsye teknike, në përputhje me Rregulloren dhe PSO-të përkatëse

Menjëherë
Pranuar

Nga intervistimi me stafin dhe shqyrtimi i praktikave ekzistuese, konstatohet mungesa e një mekanizmi të strukturuar komunikimi dhe bashkëpunimi shkresor ndërmjet Drejtorisë së Prodhimit të Ujit dhe Drejtorisë së Shpërndarjes. Konkretisht, nuk ka një praktikë të konsoliduar të raportimeve të rregullta shkresore nga Drejtoria e Shpërndarjes, lidhur me situatën reale të furnizimit me ujë në terren, mungesat dhe vështirësitë e basara në zona të caktuara. Mungesa e këtyre informacioneve kufizon aftësinë e Drejtorisë së Prodhimit për të bërë një analizë efektive të balancës ndërmjet kërkesës dhe ofertës së ujit, duke ndikuar negativisht në planifikimin operativ dhe reagimin në kohë reale ndaj problematikave të furnizimit.

Numbri i Gjetjes Nr.2

Subjekti Audituar

Njësitë/Subjektet e Interesuara

Përshkrimi i Gjetjes nr 2

Departamenti Teknik/DPTU

Drejtoria e Shpërndarjes

Mungesa e një bashkëpunimi të rregullt dhe të dokumentuar ndërmjet Drejtorisë së Shpërndarjes dhe asaj të Prodhimit lidhur me raportimin e situatës së furnizimit me ujë në zona



UJËSJIJELLËS
KANALIZIME
 RAJON DURRËS

Adresa: L. Rr. Oqilip Peza e-mail: info@shkrkri@ndurres.al

	<p>të ndryshuar, çon në mungesë të informacionit të nevojshëm për analizën e kërkesës dhe ofertës.</p>
<p>Situata</p>	<p>Raportet shkresore mbi situatën e shpërndarjes së ajrit dhe problematikat në furnizim nuk janë të prirshme ose të rregullta, duke sjellë mungesë komunikimi formal ndërmjet dy Drejtorive.</p>
<p>Kriteri</p>	<p>Praktikat e mira të menaxhimit operacional dhe kërkesat për koordinim të ndërmjetshëm kërkojnë shkëmbim të rregullt dhe të dokumentuar informacioni ndërmjet njërive përgjegjëse, në mënyrë që të sigurohet një planifikim dhe menaxhim i saktë i burimeve.</p>
<p>Ndihim/Efektet</p>	<p>Mungesa e informacionit të detajuar mbi vështirësitë të shpërndarjes kufizon analizën efektive të kërkesës dhe përbëjnë ndërlidhjen e shpejtë të Drejtorisë së Prodhimit për përmirësimin e furnizimit. Rrezikohet gjithashtu koordinimi në menaxhimin e prishjeve nga fuqitë të furnizimit në zona problematike.</p>
<p>Niveli Vlerësimit të Riskut</p>	<p>U mesëm</p>
<p>Konkluzioni</p>	<p>Mungesa e një njësi formal komunikimi ndërmjet drejtorive paraqet një mangel që ndikon negativisht në funksionimin e integruar të sistemit të furnizimit me ujë.</p>
<p>Rekomandim 2</p>	<p>Të vendoset një mekanizëm formal raportimi periodik nga Drejtoria e Shpërndarjes dhe Drejtoria e Prodhimit, i cili të përmbajë informacion mbi zonat me mungesë furnizimi, vështirësitë në shpërndarje dhe nevojat emergjente. Raportet duhet të jenë mëjore ose sipas nevojës dhe të dokumentohen në mënyrë të standardizuar.</p>
<p>Afati Fundit për zbatimin e Rekomandimit Statusi i Rekomandimit</p>	<p>Menjëherë / Pranuar</p>

✓ Hartimin e Regjistrit të Riskut dhe hapolarje përndiqer per te.

Në lidhje me Regjistrin e Riskut bazuar në ardhurin e brendshëm Nr 34 dt 26.02.2023, ka nisur puna për hartimin e këtij regjistri për Vitin 2025

✓ Hartimin e Planëve të Kontrollit të Brendshëm dhe zbatimin e tyre analiza plan buxhet shembull një muaj

Gjate shqyrtimit të dokumentacionit të parakrit nga Drejtoria e Prodhimit dhe Transmetimit të Ujit (DPTU), u konstatua se kjo Drejtori operon mbi bazën e planeve të mundës të miratuara, si në nivel vjetor, ashtu edhe mujor. Konkretisht, janë parajqitur:

- Plan vjetor i punës i DPTU, i dokumentuar me shkresën Nr. 1502 Prot., datë 02.04.2024
- Plan mujor i punës për muajin Prill 2024, i dokumentuar me shkresën Nr. 1619 Prot., datë 11.04.2024

Këto dokumente megjandë se veprimtarinë e Drejtorisë është e strukturuar dhe orientuar sipas objektivave dhe veprimtarive të planifikuara për çdo periudhë. Për më tepër, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Rregulloren dhe për të siguruar një transparencë të plotë në menaxhimin dhe ndjekjen e planeve, Drejtari i DPTU ka bërë gati dhe parajqitur dhe parajqitur pranë menaxhimit të lartë një informacion mbi kursin dhe zbatimin e detyrave të planifikuara, si dhe mbi disa problematika të konstatuara gjatë zbatimit të planit mujor. Ky informacion është bërë me shkresën Nr. 2085 Prot., datë 15.05.2024, dhe është dërguar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme për raportin dhe ndjekje të punës.

• **Sektori i Burimeve Hidrike dhe STP-ve**

✓ Raportimet e prodhimit mujor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit zyrtar rezultoi se Drejtoria e Prodhimit dhe Transmetimit të Ujit (DPTU) ka realizuar raportime periodike ndaj menaxhimit të lartë, në përputhje me kërkesat për transparencë dhe ndjekje të performancës operationale.

Me shkresën Nr. 1991 Prot., datë 10.05.2024, Drejtari i DPTU i është drejtuar menaxhimit të lartë me një raportim të detajuar mbi punën për periudhën Prill 2024. Dokumenti përmban të dhëna për prodhimin e ujit nga të gjitha burimet për periudhën Janar -Prill 2024, duke mundësuar analizë krahasuese dhe vlerësim të konditave mujore në funksion të planifikimit tëzotik dhe strategjik.

Gjithashtu, me shkresën Nr. 5961 Prot., datë 10.12.2024, është realizuar një raportim përmbledhës mbi prodhimin e ujit për periudhën njëvjeçare, me të dhëna të ndara sipas njësive operationale. Ky raport përmban një mjete të rëndësishme për vlerësimin e efiçencës



së prodhimit dhe për identifikimin e problematikave ose mungësiveve të prurjeve sipas zonave.

Raportimet janë të strukturuar të ndështruar me të dhëna numerike dhe paraqiten në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregulloret e brendshme për raportimin periodik teknik.

- ✓ Analize mbi gjendjen e matësve historikun e tyre dhe planin e zëvendësimit (raporti)
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga DPTU me emailin e datës 14.04.2025, rezultoi se monitorimi i prodhimit të ujit në stacionet e Fushë Kuqes, Fushë Mëlotit dhe Fushë Krujës - të cilat furnizojnë Njësitë Operative Durrës dhe Shijak - realizohet përmes sistemit SCADA. Ky sistem ofron të dhëna në kohë reale mbi prurjet, nivelet e rezervuarëve, presionin dhe humbjet e ujit brenda stacioneve të prodhimit, duke mundësuar një kontroll të avancuar operacional dhe reagim të menjëhershëm ndaj devijimeve apo avarive.

Megjithatë, është evidentuar se në momentin e përfundimit të kontratave të mirëmbajtjes për sistemin SCADA, ai del jashtë funksionit, duke u bërë të pamundur monitorimin në kohë reale dhe regjistrimin e saktë të të dhënave. Kjo sjell një bashkë të rëndësishëm në gjatëmbledhjen e të dhënave teknike dhe ndikon negativisht në menaxhimin efektiv të rejtit të prodhimit.

Situata e mësipërme përben një risk të konsiderueshëm për ndërprerjen e kontrollit teknik dhe për krijimin e mospërputhjeve ndërmjet prodhimit teknik dhe atij të raportuar.

Numri i Gjetjes Nr.3

Subjekti Audituar

Njësitë/Subjektet e Interesuara

Përshkrimi i Gjetjes nr 3

Situata

Dr. Teknikë, Dr. Pr., T. J.

D.P.T.U

Sistemi SCADA që monitoron në kohë reale prodhimin dhe humbjet e ujit në stacionet e Fushë Kuqes, Fushë Mëlotit dhe Fushë Krujës del jashtë funksionit në momentin e përfundimit të kontratave të mirëmbajtjes. Kjo situatë krijon një ndërprerje të papranueshme në procesin e monitorimit teknik dhe menaxhimit operacional të burimeve ujore.

SCADA del jashtë funksionit sipas përfundimit të kontratave të mirëmbajtjes, duke ndërprerë monitorimin e të dhënave kritike për prodhimin dhe humbjet. Nuk janë marrë masa të parashikueshme për



**UJËSJELLËS
KANALIZIME
RACIONI DËRRËS**

Adresat: D.D. Nr. Djalip Peza e-mail: info@shrukd@ukdurrës.al

Kriteri

vazhdimësinë teknike të sistemit pas skadimit të kontratës
Sipas standardeve të menaxhimit teknik dhe operativ, sistemet kritike si SCADA duhet të jenë të operueshme në mënyrë të vazhdueshme, me kontrata mirëmbajtjeje të përdërpëra dhe procedura për menaxhimin e riskut të ndërprerjes së funksionit.

Ndikim/Efekt

- Humbje e monitorimit të kohë reale
- Pamundësi për evidentim të saktë të numbeve funksionale stacioneve
- Risk për gabime në raportim dhe vendimmarrje të informuar
- Rritje e vonesave në rindërtim teknike të rast defektues
- Cënim i efikasitetit të operimit dhe transparencës teknike

Niveli Vlerësimit të Riskut

U mesëm

Konkluzioni

Mosgarantimi i funksionimit të pandërprerë të sistemit SCADA përshën një çështje të rëndësishme në menaxhimin teknik të prodhimit të ujit. Nevojitet një qasje e qëndrueshme për mirëmbajtjen e vazhdueshme të këtij sistemi kritik.

Rekomandim 3

Te sigurohet vazhdimësi e kontratave të mirëmbajtjes së sistemit SCADA për të garantuar funksionimin e pandërprerë.

Te hartohet një plan rezervë dhe mekanizëm kolimtar për mbulim manual të të dhënave në raste ndërprerjeje.

Të parashikohet në buxhet shpenzimi i qëndrueshëm për mirëmbajtjen e sistemeve automatike të monitorimit si SCADA.

**Afati Fundit për zbatimin e Rekomandimit
Statusi i Rekomandimit**

**Menjëherë
Përfunduar**

Burimet që furnizojnë Njësine Operative Kavajë: Burimi i Çernës, Manskurisë dhe burimet Kavajë (Fshat (Harizaj 1, Harizaj 2, Harizaj 3, Harizaj (Haxhaj), Harizaj Shizolla, Hajdëraj Bardhor, Bago) dhe meqë cilat nuk kanë matës në funksion dhe monitorohen çdo ditë me përlogaritje.

Rezervuari Manskurisë nuk është në funksion dhe është bërë kontrata për rikonstrukcion.

Burimet që furnizojnë Njësine Operative Rragozhinë, burimi i Çernës, burimi qytet (stacioni Rragozhinës) si dhe është jashtë funksionit dhe burimet fshat (Sinebalaj, Leka, Ballaj, Gethi i madh, Gjesë e Vogël dhe Vllbaskovë). Monitorimi i prodhimit të ujit bëhet çdo ditë me matje te përlogaritje, pasi nuk kanë matës në funksion.

Burimet që furnizojnë Njësine Operative Krujë: Burimet Sakarrec-Sakretë, Livadh-Skretë, Bogdan, Ujaspot, Fshati Pierrak, Fshati Hasan, burime të cilat janë me vetërrjedhje. Në këto burime monitorimi i prodhimit të ujit bëhet me përlogaritje.

Numri i Gjetjes Nr.4

Subjekti Audituar

Njësiti/Subjektet e Interesuara

Përshkrimi i Gjetjes nr 4

Dep./Fek/Dr.P.T.U/Sek. burim hidrike

Dr.P.T.U/Sektori i burimeve hidrike

Nga auditimi i gjendjes së matësve në burimet hidrike rezultoi se shumë burime që furnizojnë Njësiti Operative Kavajë dhe Rragozhinë dhe Krujë, janë pa matës funksionalë, dhe monitorimi i sasisë së ujit prodhuar kryhet përmes përlogaritjeve ditore, jo përmes matjes faktike. Për më tepër, mungon një analizë historike dhe teknike mbi gjendjen e matësve, ciklet e mirëmbajtjes dhe planifikimin për zëvendësim.

Situata

Burimet hidrike të Njësive Operative Kavajë, Rragozhinë dhe Krujë, operojnë pa pasurje funksionale matës për prodhimin e ujit, çka e bën monitorimin të pasaktë dhe të pambështetur në të dhëna reale. Burime të tilla si Çerna, Manskuria, Harizaj (1-3), Hajdëraj Bardhor, Bago, Sigaballaj, Leka, Ballaj, Gethi i Madh, Gjesë e Vogël dhe Vllbaskovë nuk kanë matës në funksion. Ndërkohë, rezervuari i Manskurisë është jashtë funksionit dhe në pritje të rikonstruksionit.



UJËSIJELLËS
KANALIZIME
RAIONI DURRËS

Adresa: 17.0r. Dalip Peka e-mail: info@shrukt@ukdurrës.al

Kriteri

- **Ligji nr. 111/2012**, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë -- Neni 4 dhe Neni 27 (detyrimet për monitorimin dhe raportimin e statusit të ujit).
- **Rregullorja e Shoqërisë** për operimin dhe kontrollin teknik të burimeve ujore (seksioni 9.3.2 pika 2).
- **Standardet ISO për menaxhimin e burimeve dhe matjen e fluksit të ujit (ISO 4064)**.

Ndikim/Efekti

Mungesa e matësve çon të pamundësinë e verifikimit real të prodhimit të ujit, gjë që çënon transparencën dhe logaritshmërinë teknike.

Matjet e përllogaritura mund të rezultojnë të pasakta, duke krijuar mospërpajtje mes prodhimit dhe shpërndarjes së ujit, si dhe rrezik për huajtje të padejftueshmëri të ujit.

- **Pasojat:** Rrezik për gabim në të dhënat teknike për sasinë e ujit që del nga burimi.
- Mungesë e bazës për analizë krahasimore ose planifikim afatgjatë për furnizimin me ujë.
- **Shkakujt:** Mungesë investimi në pajisje të matjes dhe mirëmbajtjes së tyre.
- Mungesë planifikimi teknik për ciklet e riparimit dhe zëvendësimit të matësve.
- Mungesë dokumentacioni të centralizuar mbi gjendjen dhe historikun e matësve.

Niveli Vlerësimi të Riskut

Imesëm

Pranuar



**UJËSIELLËS
KANALIZIME**
RAJONI DURRËS

Adresat: 17.Rr.Dalip Peza

e-mail: jntushrukt@ukidurres.al

Konkluzioni

Mirëmbesa e matësve funksionale në burimet hidrike dhe përdorimi i metodës së perçlogaritjes për matjen e sasise së ujit përben një mungesë në sistemin teknik të monitorimit dhe transparencës. Moshatimi i kriterëve ligjore për matje të sasise se ujit bie ndesh me kërkesat e menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e kontrollit teknik dhe vendimmarrjet operationale

Rekomandim 4

1. Të kryhet një inventarizim dhe analizë e plotë teknike e gjendjes së të gjithë matësve në burimet hidrike të Njësive Operative Kavajë dhe Krogovhinë.
2. Të përgatitet një plan ndërhyrjeje dhe investimi, për zëvendësimin, riparimin dhe vendosjen e matësve të rinj në të gjitha burimet hidrike.
3. Të hartohet dhe miratohet një procedurë e përditësuar për kontrollin, kalibrimin dhe mirëmbajtjen periodike të matësve.

Afati Fondit për zbatimin e Rekomandimit
Statusi i Rekomandimit

Menjëherë
Pranuar

Sektori i Transmetimit.

- ✓ Raportim avazi stacione pompimit, delegali urdhër Drejtoria Mirëmbajtjes
Nga intervistimi me stafin dhe shqyrtimi i praktikave operative të ndjekura në Drejtorinë e Pradhimit dhe Transmetimit të Ujit (DPTU), u konstatua se infrastrukturimet mbi avazin në stacionet e pompimit regjistrohen në mënyrë të thjeshtuar pranë DPTU, ndërsa përgjegësia për ndërhyrjen dhe dokumentimin teknik të ndërhyrjeve u takon strukturave të Drejtorisë së Mirëmbajtjes.
Më konkretisht, DPTU mban vetëm evidencën fillestare të qoftë mirë apo ndodhjes së avazit, ndërkohë që veprimet për diagnostikimin, ndërhyrjen dhe rikuperimin teknik realizohen dhe dokumentohen nga Drejtoria e Mirëmbajtjes.

Kontrolli brendshtet

- Kontrolli brendshtet bëhet bazuar në planin mujorë dhe vjetorë.



**UJËSJELLËS
KANALIZIME**
RAJONI DURRËS

Adresa: L. 17. Rr. Da Ip Perë e-mail: info@ukd@ukdurrës.dl

- ✓ Rregjistri i riskut
Në lidhje me Rregjistrin e Riskut bazuar në udhërorin e brendshëm nr 34 dt 26.02.2025, ka nisur puna për hartimin e këtij regjistri për Vitin 2025.
- 4. Drejtoria e Shpërndarjes të Ujit
- ✓ Rregullora e brendshme e funksionimit të Drejtorisë dhe përshtatja e çdo pozicioni pune
- ✓ Me shkresën me nr 1958/3 Prot DSH i është përgjigjur pikës së mësipërme duke sjellur një kopje nga rregullorja e Shoqërisë. **Mungon analiza e pozicioneve të punës sipas faktit.**
- ✓ Hartimin e Rregjistrit të Riskut dhe hapat e nevojshëm për të.
- ✓ Në lidhje me Rregjistrin e Riskut bazuar në udhërorin e brendshëm nr 34 dt 26.02.2025, ka nisur puna për hartimin e këtij regjistri për Vitin 2025.
- ✓ Hartimin e Planëve të Kontrollit të Brendshëm dhe zbatimin e tyre analiza planit huxhët shembull një muaj

<p>Numri i Gjetjes Nr.5 Subjekti Audituar Njësitë/Subjektet e Interesuara</p>	<p>Dep./Eks./Dr. Shpërndarjes Drejtoria shpërndarjes</p>
<p>Përshkrimi i Gjetjes nr 5</p>	<p>Pavarësisht se Drejtoria ushton funksione të lidhura me kontrollin e brendshëm, vërehet mungesa e dokumentacionit mbinjësitës që të vërtetojë zbatimin në praktikë të këtyre kontrolleve. Nuk është evidentuar dokumentacion që dëshmon monitorimin sistematik të proceseve kyçe, kryerjen e kualiteteve të përputhshmërisë me procedurat e brendshme, si dhe vlerësimin e arritjes së objektivave të Shoqërisë.</p>
<p>Situata</p>	<p>Gjatë auditimit u konstatua se Drejtoria e Shpërndarjes së Ujit nuk disponon një plan të miratuar të kontrollit të brendshëm për vitin në shqyrtim. Drejtoria e Shpërndarjes nuk ka evidentuar aktivitetet që lidhen me kontrollin e brendshëm si: vlerësimi i riskut, mjekëqytje e</p>

Kriteri	vazhdimshme, dokumentim kontrollësh të brendshme, ose analizo për përpuljen e procedurave standarde të operimit.
Ndihim/efekti	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 9 dhe 10, si dhe udhëzimi i MP për zbatimin e kontrolleve të brendshme financiare.
Niveli Vlerësimi të Riskut	Mundësi e planifikimit dhe kontrollit të brendshëm tri mundësi për keqmenaxhim të burimeve dhe paimundësi për të vlerësuar arritjen e objektivave
Konkluzioni	U mesëm
Rekomandimi 5	Drejtorit e Shpërndarjes së Ujit rak ka pambushur detyrimet ligjore për hartimin dhe zbatimin e planeve të kontrollit të brendshëm. Kërkoet hartimi dhe miratimi i një plani vjetor të kontrollit të brendshëm, të strukturuar sipas periadhave kohore (majet, tranzitor), që të përfshijë tashmë me risk të lartë dhe objektivat kryesorë të kontrollit
Afati Fundit për zbatimin e Rekomandimit	Mënjëherë
Statusi i Rekomandimit	Prauar

-Sektori i operimit të sistemeve shpërndarëse

- ✓ Monitorimi i tyreve kryesore, dokumentim Masat për evidentimin dhe eliminimin e humbjeve në skemat shpërndarëse duke bashkëpunuar ngushtë me Sigtorinë UPE (mënyra s. vepror)

Monitorimi i shpërndarjes së ujit mbahet në një regjistër, ku shënohet çdo rast i arritur në dispecerin ankesat dhe delegimi. NJA konstatojnë se nuk ka një dokumentacion se si ndiqen këto problematika, nuk ka një analizë sa të zgjedhën dhe si u monitor masa të rastit të veçanta. Më tej thërrë në intervista shpjegohet se e gjithë puna kryhet por mungon një dokumentim i saj.

Monitorimi bëhet sipas hapave të mëposhtme:

Shënohet çdo rast i arritur në dispecerin në librin e dorëzimit

Shënohet formati i ankesës

Problemtikat dërgohen në Dr. e mirëmbajtjes.



**UJËSJELLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresa: L7, Nr. Dalia, Peza e-mail: info@hrukd@ukdurres.al

Numbri i Gjetjes Nr.6
Subjekti Audituar
Njësitë/Subjektet e Interesuara

Dop/Tel./Dr. Shpërndarjes
Drejtoria Shpërndarjes

Përshkrimi i Gjetjes nr.6

Monitorimi aktual i situatave operacionale realizohet në mënyrë manuale përmes një regjistri, ku regjistrohen rastet e ardhura të dispecerit, ankësat dhe de'opimet. Nuk ekziston një sistem i automatizuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave.

Situata

Evidencat dhe menaxhimi i situatave operacionale ruhen në mënyrë manuale pa një strukturë të qartë për analizë, ndjekje performante dhe raportim. Mungojnë analiza periodike dhe indikatorë matës për matjen e efikasitetit operacional.

Kriteri

Standardet e menaxhimit operacional dhe kontrollit të brendshëm kërkojnë monitorim sistematik, analizë të të dhënave dhe raportim për performancën e sektorëve. Ligji nr. 10296/2010 „për menaxhimin financiar dhe kontrollin (nën. 16), kërkon sigurimin e një mekanizmi për monitorimin e brendshëm dhe vlerësimin e performancës.

Ndikim/Efekt

Mungesa e një sistemi të qartë dhe të strukturuar për ndjekjen dhe analizimin e situatave operacionale rrit mundësitë për mesidentifikimin kohë të problemeve të tija, si dhe zbatim të mungët të masave parandaluese.

Niveli Vlerësimit të Riskut

I mesëm

Konkluzioni

Sistemi aktual i monitorimit dhe ndjekjes operacionale shihet të jetë me këqerent.

Rekomandimi 6

Rekomandëhet krijimi dhe vendosja në funksion e një sistemi elektronik të menaxhimit të ngjarjeve dhe analizës së performancës operacionale, që të mundësojë regjistrimin në kohë reale, përparimin, analizimin dhe raportimin e të dhënave.

Alfati Fundit për zbatimin e Rekomandimit
Statusi i Rekomandimit

Menjëherë
Pranuar

- ✓ Raportin avari sistemet shpendarëse, delegimi udhëz Drejtoria Mirëmbajtjes

Numri i Gjetjes Nr.7	Dep/Tele/Dr. Shpërndarjes
Subjekti Audituar	Drejtoria shpërndarjes, Drejtoria e Mirëmbajtjes
Njësiti/Subjektet e Interesuara	
Përshkrimi i Gjetjes nr.7	Nuk ekzistoi një sistem formal i raportimit të avareve në rrejet shpërndarëse të ujit. Gjithashtu mungojnë dokumentet që e vërtetojnë delegimin zyrtar të detyrave për ndërhyrje drejt Drejtorisë së Mirëmbajtjes.
Situata	Avari të rrejet shpërndarëse në mënyrë të pjesshme dhe të pastruktuar, pa ndjekur një linjë formale komunikimi dhe dokumentimi.
Kriteri 0020	Standardet e menaxhimit të shërbimeve publike dhe të kontrollit të brendshëm kërkojnë: dokumentim formal të detyrave, procedurave të qarta për menaxhimin e emergjencave dhe lista të dokumentuara raportimi. Ligji nr. 20296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" (nësi 10), kërkon qartësi dhe dokumentim të strukturës operacionale.
Ndikim/Efekt	Mungesa e një sistemi formal të raportimit dhe e dokumenteve të delegimit krijon paqartësi në përgjegjësi institucionale, rrit rrezikun për vonesa në ndërhyrje, mungesë koordinimi dhe mosreagim të shpejtë ndaj situatave emergjente, duke kompromentuar cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve.
Niveli Vlerësimit të Riskut	U mesëm
Konkluzioni	Gjatë auditimit është konstatuar se nuk ekziston një sistem formal i raportimit dhe trajtimit të

20



UJËSJELLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS

Adresa: T.7. Nr.12alip Puzi e-mail: info@shukdo@ukdufres.al

avarive në mënyrë të shpërndarjes së tyre. Për më tepër, mungojnë dokumente zyrtare për delegimin e detyrave midis Drejtorisë së Shpërndarjes dhe Drejtorisë së Mirëmbajtjes, si dhe një protokoll i qartë i veprimit në situata emergjente.

Kjo mungesë dokumentacioni dhe procedurash strukturore sjell:

- Paqartësi në ndarjen e përgjegjësisve operacionale;
- Rraje të rrezikut për vonesa në ndërhyrje;
- Komprometim të cilësisë së shërbimit ndaj abonentëve;
- Morespektim të standardeve të Të gjithë nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Rekomandim 7

Rekomandohet krijimi i një sistemi formal të raportimit të avarive, me formate të standartizuara dhe procedura të unifikuar të komunikimit. Duhet të hartohen dhe miratohen dokumente të delegimit të detyrave ndërmjet sektorëve, si dhe të përgatitet një protokoll i detajuar veprimi për menaxhimin e situatave emergjente, duke përfshirë përgjegjësitë, burimet dhe linjat e komunikimit.

- Përcaktimi i qarte i zinxhrit të përgjegjësisve dhe dokumentimi përmes udhryeve të brendshëm/delegimeve;
- Zhvillimi i një procedure standarde (SOP) për reagimin ndaj avarive, me afate të caktuara për përgjigje dhe ndërhyrje.

Koordinimi me i naftë me Drejtorinë e Mirëmbajtjes dhe raportimi i përbashkët i zgjidhjeve teknike.

Afati Fundit për zbatimin e Rekomandimit

Mënyherë

Statusi i Rekomandimit

Pranuar

✓ Rregjistrimi i riskut

Në lidhje me Rregjistrimin e Riskut bazuar në udhërinë e brendshme nr 34 dt 26.02.2025, ka nisur puna për hartimin e këtij regjistri për vitin 2025.



**UJËSJIELLËS
KANALIZIME**
RAJON Durrës

Adresa: 17 Rr. Dajup Beza e-mail: inf@shukdr@shukdrins.al

Funksioni i kontrollit të brendshëm

Nuk është identifikuar ekzistenca e një mekanizmi funksional të kontrollit të brendshëm brenda Drejtorisë së Shtëpisë. Mungon dokumentacioni që vërteton kontrollin të brendshëm, monitorimin të proceseve kyçe apo analiza të përputhshmërisë me procedurat dhe objektivat e Shoqërisë.

Rekomandimi:

- Të vendoset një funksion aktiv i kontrollit të brendshëm në nivel drejtorie.
- Hartimi i një **Plani të Kontrollit të Brendshëm** për proceset operacionale.
- Zbatimi i një cikli të rregull monitorimi dhe raportimi (muajor/tremujor).
- Evidentimi i detyrësive dhe propozimi i masave korrigjuese nga vetë struktura përkatëse.

Sektori i Monitorimit të cilësisë së ujit

- ✓ Monitorimi i cilësisë së ujit, dokumentimi rigorozi me veçitë rëndësore.

Kryerja e analizave të cilësisë së ujit të përsëritshme realizohet nëpërmjet një monitorimi të brendshëm bazuar në PSO Nr. 1003.

NJA konstaton nga dokumentacioni i sjellë, se tek raportimet e klorit të lirë mbetet nga totali i analizave të kryera ka mostra që janë brenda normës së lirisë dhe mostra që janë jashtë normës.

Pikërisht për këto mostra jashtë normës ka vetëm raportim në tabelat excel

Masat të cilat duhet të adresohen, sektori të klorinimit nuk ekzistojnë, këto masa janë vetëm verbale. Pra ka angazhim në problem, por mbetet vetëm në kuadrin verbal.



<p>Numri i Gjetjes Nr.8 Subjekti Audituar Njësira/Subjektet e Interesuara</p>	<p>Dep./Telo/Dr./Sh./S.M.C.U Dr.Sh./Sektor Klementin SMCU Dr.Mirimbajte.</p>
<p>Përshkrimi i Gjetjes nr.8</p>	<p>Nga totali i mostrave të analizuara, një numër i konsiderueshem rezultojnë jashtë normës së lejuar për klor të mbetur në ujë e pijshëm. Nuk janë marrë masa të dokumentuara (me shkrim) nga strukturat përkatëse për sektorin e klorinimit, në përgjigje të këtyre devijimeve.</p>
<p>Situata</p>	<p>Japë kryer analiza laboratorike mbi cilësinë e ujit të pijshem, ku një përqindje e dukshme e mostrave ka rezultuar me vlera të klorit të mbetur jashtë kufijve të përcaktuar në standardet përkatëse. Në këtë kuadër veprimet kryhen për janë vetëm verbalë dhe mungon dokumentacioni përkatës</p>
<p>Kriteri</p>	<ul style="list-style-type: none"> VKM nr. 379, datë 25.05.2016 ndryshuar me VKM nr. 403, datë 19.06.2024 : përaktor kufijtë e pranueshëm për klorin e mbetur në ujë e pijshëm. PŞO 1003, Manualet e brendëshme teknike dhe procedurat operative standarde të institucionit për kontrollin e cilësisë së ujit
<p>Ndihim/Efekt</p>	<p>Shkakut</p> <ul style="list-style-type: none"> Mungesë e procedurave të qarta për reagim të menjehershëm ndaj devijimeve.
<p>Niveli Vlerësimi të Riskut</p>	<p>I mesëm</p>
<p>Konkluzioni</p>	<p>Mungesa e dokumentacionit ndaj rezultateve jashtë normës për klorinim paraqet dobësi në sistemin e kontrollit të brendshëm për cilësinë e ujit të pijshëm. Kjo gjë kërkon ndërhyrje për të</p>

Rekomandim 8

siguruar që masat parandaluese dhe korrigjuese të dokumentohen së duhet.

1. Të kërcojë sistemin e raportimit ndërsektorial, duke siguruar që rezultatet e analizave të dërgohen dhe analizohen rregullisht nga sektori i prodhimit dhe klorinimit, për të adresuarë masa parandaluese ose korrigjuese.

2. Të dokumentojë çdo masë të ndërmarre në lidhje me vlerat jo në përputhje të klorit, për të siguruar transparencë dhe gjurmueshmëri përpara auditimeve të ardhshme apo inspeksioneve nga institucionet rregullatore

Afati Fundit për zbatimin e Rekomandimit
Statusi i Rekomandimit

Menjëherë
Përfunduar

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit u konstatau se grupi i punës për hartimin e Planit të Monitorimit të Cilësisë së Ujit (PMCU) ka vepruar në mënyrë të një udhëri të posaçëm të lëshuar nga Administratori, siç parashtohet në PSO-në nr. 1003, pikë 6 dhe 6.1. Edhe pse grupi ka funksionuar nën drejtimin e Përgjegjësit të SMCU-së dhe ka përmirësuar disa teknika, mungesa e formalizimit përbën një shuallgje nga kërkesat procedurale të shfaqërisë. Kjo tregon nevojën për përditësim të PSO-së ose për përfshirjen e çantë të këtij mekanizmi në Rregulloren e Shoqërisë.

Gjetje nr 9

Subjekti Audituar
Njësitë/Subjektet e Interesuara

Departamenti Teknik /SMCU
SMCU

Përshkrimi i Gjetjes nr 9

Grupi i punës për hartimin e Planit të Monitorimit të Cilësisë së Ujit (PMCU) është ngritur dhe ka funksionuar pa pasur një udhëri të posaçëm të lëshuar nga Administratori, siç kërkohej nga PSO nr. 1003, pikë 6 dhe 6.1.



Situata	Grupi ekziston dhe ka vepruar nën drejtimin e Përgjegjësit të SMCU-së, por pa bazë formale të dokumentuar.
Kriteri	PSO nr. T003, pjesa 6 dhe 6.1 kërkon që hartimi i PMCU të bëhet nga një grup pune i ngritur me urdhër të Administratës. Gjithashtu, Rregullorja e Shoqërisë kërkon formalizim të veprimeve organizative.
Ndikimi/Efekti Shkak (pasaja) Niveli Vlerësimit të Riskut	Mungesa e formalizimit përmes urdhrit administrativ bie ndesh me pikat në PSO. 1 mesëm
Konkluzioni	Praktika aktuale e funksionimit të grupeve të punës duhet të jetë në përputhje me kërkesat dokumentare dhe të bazohet në vendime të dokumentuara si edhe administratave ose të reflektohet në rregullore.
Rekomandim 9	<ul style="list-style-type: none"> 1. Rekomandohet që Shoqëria të ndërtojë një nga masat e mëposhtme për të shmangur paqartësitë në të ardhmen: <ul style="list-style-type: none"> a. Të përcaktohen/ndryshohen PSO-të përkatëse për të përuaruar qartë rastet kur nevojitet urdhër i veçantë dhe për të specifikuar mënyrën e nguljes së grupeve të punës b. Të përfshihet në Rregulloren e Shoqërisë një nen që përshkruan ngritjen dhe funksionimin e grupeve të punës teknike, për të siguruar bazë të qëndrueshme procedurale dhe legjitime
Afati Fundit për zbatimin e Rekomandimit Statusi i Rekomandimit	Menjëherë Pranuar



- ✓ Katerja e analizave periodike për klorin mbetës në pikat fundore të zonave që mbulon Laboratori Qendror të përcaktimit e matësve edhe nga institucionet shëndetësore kompetente.

Nga raportimet mujore, është përshkruar dhe analiza periodike për klorin e lirë mbetës në pikat fundore të zonave që mbulon laboratorin. Konstatohet që ka dësje që tregojnë klorin e lirë mbetës si dhe parametrat mikrobiologjik për cilësinë e ujit të pijshëm. Ka fletë analiza për regjestrin kimik.

Një konstatim se duke u bazuar në ISO 1003 ka thuhet se pikat e monitorimit ku marrëni kampionet e ujit të pijshëm përcaktohen në marrëveshjen e lidhur midis strukturave rajonale të shëndetit publik dhe shoqërisë, kjo marrëveshje nuk ekziston

Numri i Gjetjes Nr.10	Dep/I ek/Dr. Sh.U/SMCC
Subjekti Audituar	Dr. Sh.U/SMCC
Njësia/Subjektet e Interesuara	Njësia e Auditimit
Përshkrimi i Gjetjes nr 10:	<p>Njësia e Auditimit konstaton se, bazuar në Procedurën Standarde të Operimit (PSO) 1003, pikat e monitorimit të cilësisë së ujit të pijshëm duhet të përcaktohen nëpërmjet një marrëveshjeje zyrtare midis strukturave rajonale të shëndetit publik dhe shoqërisë. Kjo marrëveshje aktualisht nuk ekziston.</p>
Situata	<p>Mungon një marrëveshje zyrtare mes shoqërisë dhe strukturave të shëndetit publik për përcaktimin dhe dokumentimin e pikave të monitorimit të ujit të pijshëm. Në praktikë, përvojë e kampionimit marrë në mënyrë të vazhdueshme bazuar në eksperiencën e stafit, pa dokument të përbashkët të miratuar.</p>
Kriteri	<ul style="list-style-type: none"> PSO 1003 Përcakton se pikat e monitorimit të ujit të pijshëm duhet të formulozohen në një marrëveshje zyrtare midis palëve.

(VKM nr. 379/2016 ose VKM nr. 403/2024) - kërkejtë që procesi i

- kontrollit të cilësisë të bazohet në dokumentacion të qartë dhe të verifikueshëm

Shkaku:

- Nevojë për përcaktimin dhe formalizimin të praktikave të bashkëpunimit ndër-institucional.

Ndikim/Efekti

Niveli Vlerësimit të Riskut

Konkrezioni

Rekomandim i0

Umesëm

Mungesa e një marrëveshjeje të dokumentuar për pikat e monitorimit bie ndesh me pikat e PSO-së dhe krijon paqartësi në gjurmueshmërinë e monitorimit të procesit I.DT/Dr.Sh.L./SMCU të ndërruarë menjëherë veprimet për hartimin dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje zyrtare me strukturat rajonale të shëndetit publik për përcaktimin e pikave të monitorimit të cilësisë së ujit të pijshëm, në përputhje me PSO T003. Marrëveshja duhet të përfshijë:

- Vendudhjet specifike të pikave të kampionimit.
- Frekuençën e monitorimit.
- Pasat përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin.

Afati Fundit për zbatimin e Rekomandimit
Statusi i Rekomandimit

Menjëherë
Prahuar

✓ Kontrolli sipas grafikut të miratuar për punën e kryer në qendrën e klorimit.

NIA konstaton se Përgjegjësit e turnit në njësinë e burimeve hidrike mbajnë kontakte me Përgjegjësin e Sektorit të Monitorimit të Cilësisë së ujit për të përshtatur dozën e klorit sipas analizave laboratorike. Përgjegjësi i SMCU nëpërmjet kontrollit kundësoi që procesi i



limiteve të prapëshme sipas PSO Nr. T005 pikë 6.1 klorinimi.

- ✓ Musat që merren për zbatimin e rregullores të cilësisë në larjet e depozitave dhe veprave hidroteknike, shkojnë raportuar për realizimin e kësaj detyre para Drejtorit të Drejtorisë së Shtepërdorjes së Ujit.

Bazuar në Rregulloren e Cilësisë së ujit të pijshëm, e cila është baza ligjore që përcakton kërkesat e cilësisë së ujit. NIA konstaton nga materiali që i është vënë në dispozicion se PSO Nr. T005 ka të gjitha hapat për dezinfektimin e ujit.

- ✓ Analiza konkrete laboratorike të çdo vasje të re të furnizimit me hipoklorit të Laboratorit Qendror dhe raportimi tek Drejtori i Drejtorisë së Shtepërdorjes së Ujit për përqindjen mesatare të klorit aktiv që përdoret për dezinfektim

Çdo furnizim me hipoklorit ka të bashkëngjitur analizën laboratorike ka përcaktimet dhe përqindja mesatare e klorit aktiv për dezinfektim

- ✓ Klerimuesi është aprovuar nga Administratori i Shoqërisë dhe është pajisur me dësarri aksesie, të lëshuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit të Cilësisë së Ujit.
Bazuar në rregulloren e shoqërisë ka klorimuesi duhet të ishte i aprovuar nga Administratori i Shoqërisë dhe i pajisur me dësarri aksesie të lëshuar nga përgjegjësi i SMCU shprehur në shkresë se është në proces.

Numri i Gjetjes Nr. 11	Dep/ Fek/ Dr. Sh. U/ S. M. C. U.
Subjekti Audituar	Dr. Sh. U/ SMCU
Njësitë/ Subjektet e Interesuara	Vlerësimi i kontrollit të brendshëm tregon se
Përshkrimi i Gjetjes nr 11	ndonëse ekzistojnë procedurat standarde të operimit (PSO), ndonëse ka një plan të detajuar për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm për çdo skemë furnizimi, mungojnë vizitëveshjet zyrtare me strukturat rajonale të

28



**UJËSJETLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresa: L. 27 Ilir Dajço Peza e-mail: info@shkrukt@ujadurres-ul

Situata

shëndetit publik për analizat që duhen kryer dhe mënyrën e raportimit

Sektori i Monitorimit dhe Kontrollit të Ujit funksionon me një plan të miratuar për

monitorimin e cilësisë së ujit. Raportimi i të dhënave të analizave mbledh vjetor në rastet kur identifikohen devijime nga norma dhe pa një marrëveshje bashkëpunimi me strukturat shëndetësore

Kriteri

- PSO Nr. 1605 dhe procedura të tjera të brendshme që kërkojnë raportim periodik dhe plan monitorimi.
- Rregullorja për cilësinë e ujit të pijshëm (VKM nr. 379/2016 ose 403/2024).

Ndihim/Efekt**Shkak:**

- Zbatim i pjesshëm i PSO-ve.

Niveli Vlerësimi të Riskut**I mesëm****Konkluzioni**

Kontrolli i brendshëm në SMCU rezultoi të jetë i pjesshëm, me rrethë mospërputhje ndërmjet praktikave të ndjekura dhe procedurave të përaktuara. Kjo situatë kërkon përmirësim të menjëhershëm përmes formalizimit të bashkëpunimeve institucionale, forcimit të dokumentacionit.

Rekomandim 11

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime, përmes Departamentit Teknik dhe strukturave përkatëse (Dr.Sh.U / SMCU), duhet të rishikojë dhe forcojë sistemin e kontrollit të brendshëm në fushën e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë së ujit të pijshëm, duke ndërmarrë këto masa konkrete:



1. Hartimin e një politike të qartë të kontrollit të brendshëm, me përfshirje të saktë për:
 - a. Krugën zyrtare të komunikimit dhe raportimit të të dhënave;

b. Detyrimin për dokumentim dhe gjurmueshmëri të çdo procedurë teknike apo analitike

2. Formalizimin dhe standardizimin e bashkëpunimit me palët e treta, përmes marrëveshjeve zyrtare me strukturat e shëndetit publik, që lidhen drejtpërdrejt me kontrollin e cilësisë së ujit.

Alati Fyqor për zbatimin e Rekomandimit
Statusi i Rekomandimit

Menjëherë
 Praunuar

Numri i Gjetjes Nr.12
Subjekti Audituar
Njësi/Subjektet e Interesuara

Dep./Tel./Dr. Sh. U/S. M.C.U.
 D/ Sh.12/SMCU

Përshkrimi i Gjetjes nr 12

Rregullorja e cilësisë së ujit të pijshëm, që udhëzon praktikën e Shqipërisë në monitorimin dhe kontrollin e cilësisë së ujit, është ende e bazuar në VKM nr. 379 datë 25.05.2016, e cila ka pësuar ndryshime me VKM nr. 403, datë 19.06.2024. Për rrjedhojë, rregullorja ekzistuese është e papërditësuar dhe mund të përmbajë çështje që nuk përputken me kadrin e ri ligjor në fuqi.

Situata

Rregullorja e brendshme mbi cilësinë e ujit vazhdon të referojë VKM-në e vjetër (nr. 379/2016), pa reflektuar ndryshimet e fundit të VKM-së së re (nr. 403/2024). Kjo mund të



<p>Kriteri</p>	<p>ndikojë në përputhshmëritë e procesit të kontrollit të brendshëm dhe të analizeve laboratorike me kërkesat aktuale ligjore.</p> <ul style="list-style-type: none"> VKM nr. 403, datë 19.06.2024 "Për cilësinë e ujit të pijshëm" (e zëvendëson VKM nr. 379/2016). Parmes e përditësimit të dokumentacionit teknik sipas ndryshimeve ligjore. Nevoja për përputhshmëri të dokumentacionit të brendshëm me aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Shfaqur Mungesë procesi të rregullt për rishikimin dhe përditësimin periodik të dokumenteve të brendshme. Pasojat Rregullorja aktuale mund të udhëzojë stafin mbi praktika që nuk janë më të vlefshme.
<p>Ndikim/Efekt</p>	
<p>Niveli Vlerësimit të Riskut</p>	<p>1 mesëm</p>
<p>Konkluzioni</p>	<p>Shoqëria duhet të përditësojë urgjentisht rregulloren e saj të brendshme mbi cilësinë e ujit të pijshëm, në përputhje me ndryshimet e miratuara në VKM nr. 403/2024.</p>
<p>Rekomandim 12</p>	<ol style="list-style-type: none"> Të rishikohet dhe përditësohet Rregullorja e cilësisë së ujit të pijshëm, duke reflektuar të gjitha ndryshimet e VKM nr. 403, datë 19.06.2024. Të ofrohet dhe trajtohet stafi teknik mbi ndryshimet përkatëse. Të sigurohet që të gjitha PSO-të dhe udhëzimet teknike të përputhen me versionin e ri të rregullores.
<p>Afati Fundit për zbatimin e Rekomandimit Statusi i Rekomandimit</p>	<p>Mënyshëre Pranuar</p>

Në kuadër të rishikimit të rregullerës së monitorimit të cilësisë së ujit sipas VKM së ndryshuar NJA ju vjet në ndihmë duke ju sqaruar se VKM e ndryshuar ofron:

- **Rritja e parametrave të kontrollit:** VKM Nr. 403 ka shtuar disa parametra të rinj që duhet të monitorohen për të siguruar cilësinë e ujit të pijshëm. Kjo përfshin analiza më të detajuara

dhe të siguruara për të identifikuar ndotës të mundshëm që mund të ndikojnë në shëndetin e konsumatorëve.

- **Përmirësimi i metodologjisë së analizave:** Metodat e analizës për disa parametra janë përmirësuar dhe standardizuar, duke siguruar rezultate më të sakta dhe të besueshme. Kjo ndihmon në identifikimin e burimeve të problemeve dhe ndërmarrjen e masave parandaluese.

- **Përditësimi i kufijve të pranueshëm për disa parametra:** Kufijtë e pranueshëm për disa substanca në ujë janë rishikuar dhe përditësuar, duke u bazuar në kuptime shkencore të fundit dhe rekomandime ndërkombëtare. Kjo siguron që uji i pijshëm të jetë në përputhje me standartet më të larta të sigurisë.

- **Përfshirja e teknologjive të reja për trajtimin e ujit:** VKM Nr. 403 inkurajon përdorimin e teknologjive moderne dhe efikase për trajtimin e ujit, duke përfshirë filtrimin dhe dezinfektimin për të eliminuar ndotësit dhe për të përmirësuar cilësinë e ujit të pijshëm.

- **Rritja e transparencës dhe informimit të publikut:** Ky vendim thekson rëndësinë e informimit të qytetarëve për cilësinë e ujit të pijshëm, duke përfshirë publikimin e rezultateve të analizave dhe masave të marra për përmirësimin e cilësisë së ujit. Kjo trë besimin e publikut dhe angazhimin e tij në ruajtjen e burimeve ujore.

4. Drejtoria e Mirëmbajtjes

- ✓ Rregullimi e brendshme e funksionimit të Drejtorisë dhe nënshlyerja e çdo pozicioni pune
- ✓ Hartimin e Regjistrit të Riskut dhe hapat që po ndiqen për të.
- ✓ Hartimin e Planëve të Kontrollit të Brendshëm dhe zbatimin i tyre. Analiza plan buxhet shembull: një muaj

32



**UJËSJIELLËS
KANALIZIME
RAIONI DURRËS**

Adresa: L. 17. Rr. Dalip Peza e-mail: info@shrukt@ukdurrës.al

Sektori i mirëmbajtjes Elektro-Mekanike

- ✓ Raportimi i avare javeqë-miqore Hartimi dhe propozimi i projekte planeve vjetore të rejonit
- ✓ Procedurat praktike avare
- ✓ Rakordimi dhe analizimi i shpenzimeve të energjisë elektrike, në përshatje të fuqisë së instaluar, duke propozuar masa konkrete për kursimin e energjisë elektrike
- ✓ Kontrolli brendshëm
- ✓ Regjistri i rrisht

Për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës të kërkuar në krah të 12 auditimit, si dhe mospunësimit të materialeve zynare nga Drejtoria e Mirëmbajtjes – Sektori Elektromekanik, nuk ishte e mundur zhvillimi i plotë i procedurave të auditimit të planifikuara për këtë shtesë

Auditimi nuk ka mundur të vlerësojë në mënyrë të verifikueshme zbatimin e praktikave të kontrollit të brendshëm, hartimin e Regjistrit të Riskut, procedurat për reagimin ndaj avareve dhe analizën e shpenzimeve energjetike, për shkak të mungesës së evidencave të dokumentuara.

Në kushtet e mësipërme, vlerësimi i performancës dhe përpajtshmerisë me kërkesat ligjore dhe rregullatore në këtë sektor mbetet i pezulluar, deri në dorëzimin e informacionit të plotë dhe të verifikueshëm nga struktura përkatëse.

5. Drejtoria e Grupballimit të UN

- ✓ Rregulloret e brendshme e funksionimit të Drejtorisë dhe përshatja e çdo pozicioni pune dhe një perspektivë të shkurtër të pozicioneve të punës, bazuar mbi rregulloret e shoqërisë

Me shërbesë me Nr 2961 Prot dt 30.05.2025 spjegohet procedura e punës për çdo pozicion. Në përputhje me rregulloret e miratuara të shoqërisë, është bërë përshatja funksionale e çdo pozicioni pune brenda Drejtorisë, duke u bazuar në palirimin e ndajjes së gjerë të kompetencave, përgjegjësi dhe fuqisë së raportimit.

- ✓ Hartimin e Regjistrit të Riskut dhe hapet që do ndiqen për të.

Në lidhje me Regjistrin e Riskut bazuar në udhëzimin e brendshëm nr 34 dt 26.02.2025, ka nisur puna për hartimin e këtij regjistri.

- ✓ Hartimin e Planeve të Kontrollit të Brendshëm dhe zbatimin e tyre. Analiza plan buxhet, shemboll hje muaj

(Në secilin nga pikat e sipërme mund të ilustroni me materiale.)

Sipas shërbesës së mësipërme, plani i punës për mirëfunksionimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura bazohet në dy komponente kryesore, të cilat përfaqësojnë hallkat më kritike të operimit dhe mirëmbajtjes:



1. **Riparimi i defekteve në tubacionet përcjellëse, të evidentuara si nga ankesat e qytetarëve, ashtu edhe nga konstatimet direkte të specialistëve të sektorit të mirëmbajtjes.**
2. **Operimi dhe mirëmbajtja e stacioneve të pompimit të ujërave të ndotura, që përbëjnë element kyq për rjedbshmërinë dhe përpunimin e qendrueshëm të ujërave në të gjithë sistemin e kanalizimeve. Veprimtaritë kryesore që realizohen në këtë drejtim përfshijnë:**
 - o **Mirëmbajtja e elektropumpave, përmes instalimit të inverteve që mundësojnë operimin automatik dhe mbrojtjen e pajisjeve nga dëmtimet mekanike.**
 - o **Pastrimi dhe mirëmbajtja periodike e zgarave protëse, për të parandaluar bllokimet dhe grumbullimin e mbetjeve të ngurta në pikat hyrëse të stacioneve.**
 - o **Pastrimi i puseve grumbulluese, për të garantuar kapacitetin normal të depozitimit dhe përpunimit të ujërave para pompimit.**
 - o **Ndërrimi i saracineskave dhe kundravahulave, si pjesë e mirëmbajtjes.**

Sektori i Operimit të rrjeteve kanalizimeve dhe STP

- ✓ **Raportimi i avare, jayore-rinjore.**
- ✓ **Kontrolloq dokumentacionin e zgjedhjes teknike për pikën e lidhjes të propozuar nga NJO duke e vlerësuar në funksion të politikave, standardeve dhe procedurave të miratuara për pikat e lidhjeve në sistemet e grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.** Nga mjetësimi NJA, konstatohet që kryhet procedura e kontrollit të dokumentacionit.
- ✓ **Procedurat praktike zvarë**
Bazuar në shkresën e mbështetje NJA konstatohet se duke uënë se k
- ✓ **Kontrolli brendeshëm**
- ✓ **Rregjistrimi rishtur**
Në lidhje me Rregjistrin e Rishtur bazuar në urdhërmirë brendshëm nr 34 dt 26.02.2025 ka nisur puna për hartimin e këtij regjistri.

5. Drejtoria e Trajtimit të UN

- ✓ **Rregullorja e brendshme e funksionimit të Drejtorisë dhe përshtatja e çdo pozicioni pune**
- ✓ **Drejtoria e trajtimit përfshin 3 (tre) impiante:**
 1. Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura Durrës,
 2. Impianti i përpunimit të ujërave të zeza Kavajë
 3. Impianti i trajtimit të ujërave të përdorura Kalëz.

Menaxherët janë ata që drejojnë punët në secilin implant. Impianti i Kavajës ka 1 (një) inxhinier mekanik që mirëmban pajisjet mekanike, kurse Impianti i Durrësit ka



2 (dy) inxhinier, një inxhinier mekanik që mirëmban pajisjet mekanike dhe një inxhinier mjedisi që ndjek procesin teknologjik të Impiantit

Impiant i Durrësit ka 2 (dy) elektricitet që mirëmbahet pajisjet nga ana elektrike, gjithashtu edhe Impiantin i Lalëzit ka 1 (një) elektricitet që mirëmban pajisjet nga ana elektrike.

Impiantin i Kavajës ka 1 (një) mekanik që mirëmban pajisjet nga ana mekanike. Impiantin i Durrësit është i pajisur edhe me lëndëulë të cilët mirëmbahet impiantin nga ana lëndëulë.

Të 3 (tre) impiantet janë të pajisur me punëtorë për të kryer punën e përditshme në impiant si bashkë, manovrim të ndryshme, mirëmbajtje etj., si dhe roje të cilët ruajnë objektet gjatë natës

Gjithashtu Drejtoria e Impianteve ka në strukturë edhe Sektorin e monitorimit të ujërave të ndotura i cili merret me monitorimit të ujërave që futen dhe dalin nga të 3 (tre) impiantet. Ky sektor ka 1 (një) përgjegjës dhe një komitë për kryerjen e analizave

✓ Hartimin e Regjistrit të Riskut dhe hapat që po ndiqen për ta

Në lidhje me Regjistrin e Riskut hazuar në udhëime brendshme nr 34 dt 26.02.2025 ka nisur puna për hartimin e këtij regjistri.

✓ Hartimin e Planëve të Kontrollit të Brendshëm dhe zbatimin i tyre, analiza plan bashkëpunuarit një muaj

Kontrolli i brendshëm kryhet nga menaxherët dhe inxhinierët e impianteve. Në bazë të detyrave të dhëna, ata bëjnë edhe kontrollin e punëve.

✓ Raportimet mujore mbi cilësinë e ujërave të trajtuara

Në lidhje me raportimet mujore mbi cilësinë e ujërave të trajtuara, Sektori i monitorimit, dërgon raporte mujore, 3 – mujore dhe 1 – vjeçare në lidhje me parametrat në lyrje dhe në dalje që kanë ujërat e ndotura. Bashkëngjitur këtij relacioni do gjeni 1 raport mujorë për vitin 2024, 1 raport 3 – mujorë për vitin 2024 dhe raportin 1 – vjeçorë për vitin 2024. Shkresat me nr 6012 Prot dt 1.12.2024, Nr 928 Prot dt 10.02.2025, n 2001 Prot dt 10.05.2024.

✓ Procedure praktike avari, delegimi udhër Drejtoria Mirëmbajtjes (kontrolli Dr.Mirëmbajtjes)

Në lidhje me procedurën praktike avari po jrr dërgojtur bashkëngjitur Kërkesën me Nr 4573 Prot. të datës 09.09.2024

✓ Planet e Emergjencës në rast përmbytjesh

35



**UJËSJELLËS
KANALIZIME
RAIONI DURRËS**

Adresa: 17 Rr/Dallp Beza e-mail: info@shrukd@ukdurrës.al

Implantet janë të pajisur me njësinë e pompave të shpirt, e cila grumbullohet dhe largon gjithë ujërat e shiçeve. Në rast probleme me energjinë elektrike, implantet i Durrësit dhe i Lezhës janë të pajisur me gjeneratorë. Ndërkohë që performancat e IJUN, veprimtaritë e mirëmbajtjes dhe riparimeve, analizat laboratorike, etj. si dhe hartat raporte përmbledhëse mujore, 3-mujore dhe vjetore.

Në lidhje me analizat laboratorike dhe raportetve përmbledhëse, referoçuri materialit bashkëngjitur për raportin 1 - rrethorë, 2 - muajorë dhe 3 - vjetorë.

- ✓ A ka kimist dhe biolog dhe si veprojnë ata bazuar në rregulloren e shpirtërisë

Implantet nuk kanë as kimist dhe as biolog në strukturë, vetëm 1 kimist është dhe ai i përket Sektorit të monitorimit dhe si detyrë ka kryerjen e analizave në laboratorin e Durrësit për të 3 (tre) implantet.

<p>Numri i Gjetjes Nr.13 Subjekti Audituar Njësite/Subjektet e Interesuara</p>	<p>Dep/Tele/Dr.trajtimit UN Dr. Trajtimit UN</p>
<p>Përshkrimi i Gjetjes nr 13</p>	<p>Në strukturat organizative të implantëve nuk parashikohet dhe nuk është pranishëm asnjë kimist apo biolog. Aktualisht ekziston vetëm një kimist në strukturën e Sektorit të Monitorimit, i cili është përgjegjës për kryerjen e analizave laboratorike për të tre implantet në laboratorin e Durrësit, duke tejkaluar kapacitetet dhe duke mos siguruar prapinë e vazhdueshme të kontrollit cilësor në vend.</p>
<p>Situata</p>	<p>Verifikimi i strukturës dhe funksionimit të implantëve tregoi mungesën e personelit teknik të specializuar (kimiste, biologë), të cilët janë të detyrueshëm për analizimin, kontrollin dhe interpretimin e parametërve të ujërave të ndotura, si dhe për sigurimin e përputhshmërisë me standartet mjedisore.</p>
<p>Kriteri</p>	<p>Rregullorja e Shqipërisë dhe kërkesat ligjore teknike për funksionimin e implantëve të</p>



Ndërkim/Efekt

trajtimit të ujërave të ndotura parashikojnë çermosidueshmëri të çrregulluar të stafit teknik të kualifikuar në vend. Gjithashtu, standardet për trajtimin e ujërave kërkojnë kontroll të vazhdueshëm laboratorik dhe mbikëqyrje nga profesionistë të leshës për të siguruar përputhjen me normat ligjore.

Mungesa e kimsistëve dhe biologëve në impiant ndikon negativisht në kontrollin e cilësisë së ujërave të trajtuara, rrit rrezikun e mosrespektimit të standardeve mjedisore dhe ekspozim Shqiptarëve

ndaj penaltiteteve dhe pasojave ligjore. Gjithashtu mbingarkon kapacitetet e vëmë ekzistuese të stafit teknik.

Niveli Vlerësimi të Riskut

I mesëm

Konkluzioni

Struktura aktuale e personelit të impiantit është jo e përshtatshme për kërkesat teknike dhe ligjore të funksionimit të tyre. Mungesa e stafit të specializuar si kimsistë dhe biologë bie nënesh në standardet e shërbimit dhe rrezikon seriozisht cilësimin e funksionimit të impianteve.

Rekomandimi 13

Rekomandohet rishikimi i strukturës organizative të impianteve dhe përfshirja në të e personelit të specializuar si kimsistë dhe biologë rezidentë, të paktën një për çdo impiant, për të siguruar kontroll të vazhdueshëm të cilësisë dhe përputhshmërisë mjedisore. Po ashtu, duhet të rregullohet bashkëpunimi funksional dhe përgjegjësi të ndërmjet Sektorit të Monitorimit dhe personelit të impianteve

Afati fundit për zbatimin e Rekomandimit
Statusi i Rekomandimit

Merzëherë,
Pranuar,

OPINION I PËRGJITHSILËM

Grupi i auditimit, në vlerësim të kompleksitetit të funksionimit të sistemit teknik dhe institucional, një kuadër të zbatimit të legjislatimit përkatës, Rregullores së Brendshme dhe Procedurave Standarde të Operimit (PSO), konstaton se, gjatë auditimit të zhvilluar në Departamentin Teknik dhe drejtimin në varesi të tij, janë evidentuar një sërë problematikash që ndikojnë në efikasitetin, transparencën dhe kontrollin e brendshëm të veprimtarisë institucionale.

Në analizë të gjerë, grupi i auditimit vlerëson se këto problematika burojnë kryesisht nga:



Adresë: 17 Rr. Dalip Pava e-mail: infosteknik@ujksdurrres.al

1. Mungesën së zbatimit të rregullave dhe procedurave të brendshme të dokumentuara, si dhe shkakës nga praktikat e mirëfillta të kontrollit të brendshëm, gjë që ka ndikuar në uljet e efikasitetit operativ dhe në rritjen e riskut institucional.

2. Dobësi në sistemin e placifikimit, dokumentimit, koordinimit dhe menaxhimit të informacionit teknik, operacional dhe analitik, të cilat çojnë parimial e përgjegjshmërisë, transparencës dhe gjurmueshmërisë së veprimave administrative dhe teknike.

Në përfundim të procesit të auditimit, u bë u bazuar në analizën e praktikave aktuale dhe vlerësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, **Risku i sistemit vlerësohet i Mesëm**.

Për një administrim sa më të mirë të dokumentimit të punës, funksionimin sa më efikasitet të kontrollit të brendshëm dhe përmirësimin e performancës institucionale bazuar në Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrat të Financave, nr.100, datë 25.10.2016, kapitull IV "Raportimi dhe komunikimi i auditimit", pikat 4.4 "Raportimi i rekomandimeve" dhe pika 4.5 "Projekt Raport dhe raport final", *auditit jep këto rekomandime:*

Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në:

- Forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut;
- Rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit institucional;
- Përmirësimin e menaxhimit të burimeve nore dhe të rrjetëve shpërndarëse,
- Sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe përpunueshmërisë me kuadrin ligjor dhe standardet teknike në fuqi.

Grupi i auditimit thekson se adresimi në kohë dhe me përgjegjësi i rekomandimeve është një detyrim ligjor dhe institucional, dhe duhet të shoqëruhet me mbikëqyrje dhe monitorim të vazhdueshëm nga niveli drejtues përkatës për të parandaluar që riasa korrigjuese të kenë impas real dhe të qëndrueshem në vepërimtarinë e shoqërisë.

5. Aneksi I

PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE

Nr	Rekomandimet (MASA ORGANIZATIVE)	Niveli Riskut
1	Gjetje 1. Nga analiza e dokumentacionit dhe intervistimi i stafit, NJA konstaton se në disa raste mungojnë urdhërat e	

38



**UJËSJELLËS
KANALIZIME**
RAJONI DURRËS

Adresa: U. D. Rr. Ualip Peta e-mail: info@urkad@ujkurres.al

	<p>brandshënia të shkruar për fikje e pompave në rast svarie nga gjatë riparimit të difekteve. Autorizimet në këto raste janë dhënë verbalisht dhe nuk dokumentohen në mënyrë të rregullt, gjë që bën ndesh me parimet e kontrolit të brendshëm dhe gurmueshmërisë së veprimave operative.</p> <p>Rekomandimi 1 - Të implementohet menjshpejt një praktikë e detyrueshme për lëshimin e urdhrave të brendshëm të dokumentuar për çdo rast të fikjes së pompave për arsye të rrepta, në përputhje me Rregulloren dhe PSO-të përkatëse</p>	
2	<p>Gjetje 2 - Mangësi e një bashkëpunimi të rregullt dhe të dokumentuar ndërmjet Drejtorisë së Shpërndarjes dhe asaj të Prodimit lidhur me raportimin e situatës së furnizimit me ujë në zonat e ndryshme, çun në mangësi të informacionit të nevojshëm për analizën e kërkesës dhe ofertes.</p> <p>Rekomandimi 2 - Të vendoset një mekanizëm formal raportimi periodik nga Drejtoria e Shpërndarjes drejt Drejtorisë së Prodimit, i cili të përmbajë informacion mbi zonat me mangësi furnizimi, vështirësi të shpërndarje dhe nevojat emergjente. Raportet duhet të jenë myqjore ose sipas nevojës dhe të dokumentohen në mënyrë të standardizuar.</p>	I mesëm
3	<p>Gjetje 3 - Sistemi SCADA që monitoron në kohë reale prodimin dhe humbjet e ujit në stacionet e Fushë Kujës, Fushë Miletit dhe Fushë Kujës del jashtë funksionit në momentin e përfundimit të kontratave të mirëmbajtjes. Kjo situatë krijon një ndërprerje të paparmeshahe në procesin e monitorimit teknik dhe menaxhimit operacional të burimeve ujore.</p> <p>Rekomandimi 3 - Të sigurohet vazhdimësia e kontratave të mirëmbajtjes së sistemit SCADA për të garantuar funksionimin e pandërprerë.</p> <p>3.1 Të hartohet një plan rezervë dhe mekanizmi kalimtar për mbulim manual të të dhënave në raste ndërprerjeje.</p>	I mesëm

4

3.2 Të parashikohet në buxhet shpenzimi i gënjehesishëm për mirëmbajtjen e sistemeve automatike të monitorimit si SCADA.

Gjetje 4. Nga auditimi i gjendjes së matësve në barimet hidrike rezultoi se shumë burime që furnizojnë Njësitë Operative Kavajë dhe Rrugozhinë dhe Krujë, janë pa matës funksionalë, dhe monitorimi i sasisë së ujit prodhuar kryhet përmes përlogaritjeve ditore, jo përmes matjes faktike. Për më tepër, mungon një analizë historike dhe teknike mbi gjendjen e matësve, ciklet e mirëmbajtjes dhe planificimin për zëvendësim.

I mesëm

Rekomandim 4.

4.1 Të kryhet një inventarizim dhe analizë e plotë teknike e gjendjes së të gjithë matësve në barimet hidrike të Njësitë Operative Kavajë dhe Rrugozhinë.

4.2 Të përgatitet një plan ndërhyrjeje dhe investimi, për zëvendësimin, riparimin dhe vendosjen e matësve të rritur në të gjitha barimet hidrike.

4.3 Të hartohet dhe miratohet një procedurë e përditësuar për kontrollin, kalibrimin dhe mirëmbajtjen periodike të matësve.

5

Gjetje 5. Pavarësisht se Drejtoria ushtron funksione të lidhura me kontrollin e brendshëm, vërehet mungesa e dokumentacionit mbështetës që të vërtetojë zbatimin në praktikë të këtyre kontroleve. Nuk është evidentuar dokumentacion që dëshmon monitorimin sistematik të proceseve kyçe, kryerjen e analizave të përputhshmërisë me procedurat e brendshme, si dhe vlerësimin e arritjes së objektivave të Shoqërisë.

I mesëm

Rekomandim 5. Kërkohet hartimi dhe miratimi i një **plani vjetor të kontrollit të brendshëm**, të strukturuar sipas periudhave kohore (muajt, tremujor) që të përfshijë fushat me risk të lartë dhe objektivat kryesore të kontrollit. Po ashtu, duhet të realizohen **analiza mujore të plan-buxhetit**, për të monitoruar performancën financiare dhe për të siguruar përdorim efikas të burimeve, në përputhje me ligjin nr. 10296/2010 dhe praktikat më të mira të qeverisjes.

6	<p>Gjetje 6. Monitorimi aktual i situatave operacionale realizohet në mënyrë manuale përmes një regjistrit, ku regjistrohen rastet e ndëruara në dispaneri, ankesat dhe delegimet. Nuk ekziston një sistem i automatizuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave</p> <p>Rekomandimi 6. Rekomandohet krijimi dhe vendosja në funksion e një sistemi elektronik të menaxhimit të ngjarjeve dhe analizës së performancës operacionale, që të mundësojë regjistrimin në kohë reale, përponimra, analizimin dhe raportimin e të dhënave</p>	1 mesëm
7	<p>Gjetje 7. Nuk ekziston një sistem formal i raportimit të avarive në rrejetë përpërndarëse të ujit. Gjithashtu, mungojnë dokumentet që e vërtetojnë delegimin zyrtar të detyrave për ndërhyrje drejt Drejtorisë së Mirëmbajtjes.</p> <p>Rekomandimi 7. Rekomandohet krijimi i një sistemi formal të raportimit të avarive, me formate të standardizuara dhe procedurë të miratuara të komunikimit. Duhet të hartohen dhe miratohen dokumente të delegimit të detyrave ndërmjet sektorëve, si dhe të përgatitet një protokoll i detajuar veprimi për menaxhimin e situatave emergjente, duke përfshirë përgjegjësitë, burimet, dhe linjat e komunikimit</p> <p>1/1. Përuajtimi i qartë i zinxhirit të përgjegjesive dhe dokumentimi përues udhëzave të brendshëm/delegimeve.</p> <p>1/2. Zhvillimi i një procedure standarde (SOP) për reagimin ndaj avarive, me afate të caktuara për përgjigje dhe ndërhyrje</p> <p>Koordinim me i rradhë me Drejtorinë e Mirëmbajtjes dhe raportim i përbashkët i zgjidhjeve teknike</p>	1 mesëm
8	<p>Gjetje 8. Nga totali i mostrave të analizuara, një numër i konsiderueshëm rezultojnë jashtë rrethit të lejueshëm për klor të mbetur në ujë e pijshëm. Nuk janë marrë masa të dokumentuara (me shkrim) nga strukturat përkatëse për sekopin e klorimit, në përgjigje të këtyre devijimeve.</p> <p>Rekomandimi 8. Të forcojë sistemin e raportimit ndërsektorial, duke siguruar që rezultatet e analizave të dërgohen dhe</p>	1 mesëm



analizohen rregullisht nga sektori i prodhimit dhe klorimit, për të ndërmarrë masa parandaluese ose korrigjuese.

8/1. Të dokumentojë çdo masë të ndërmarrë në lidhje me vlerat jo në përputhje të klorit, për të siguruar transparencë dhe gjurmueshmëri përpara auditimeve të ardhshme apo inspeksioneve nga institucionet rregullatore.

9

Gjetje 9. Grupi i punës për hartimin e Planit të Monitorimit të Cilësisë së Ujit (PMCU) është ngjitur dhe ka funksionuar pa pasur një udhëz të posaçëm të lëshuar nga Administratori, siç kërkohet nga PSO nr. T003, pikat 6 dhe 6.1.

Rekomandim 9. Rekomandohet që Shqipëria të ndërmarrë një nga masat e mëposhtme për të shtrënguar paqartësitë e të ardhmen:

9.1 Të rinfreskohen/ndryshohen PSO-të përkatëse për të përcaktuar qartë ruset kur rrevohet udhëz i veçantë dhe për të specifikuar mënyrën e ngritjes së grupeve të punës.

9.1.1 Të përfshihet në Rregulloren e Shoqërisë një nen që përcakton ngritjen dhe funksionimin e grupeve të punës teknike, për të siguruar bazë të qëndrueshme procedurale dhe legjitime.

I mesëm

10

Gjetje 10. Njësia e Auditimit konstaton se, bazuar në Procedurën Standard të Operimit (PSO) T003, pikat e monitorimit të cilësisë së ujit të pishëm duhet të përcaktohen nëpërmjet një marrëveshjeje zyrtare midis strukturave rajonale të shëndetit publik dhe shoqërisë. Kjo marrëveshje aktualisht nuk ekziston.

Rekomandim 10. DT/Dr. Sh.U/SMCU të ndërmarrë menjëherë veprimet për luftimin dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje zyrtare me strukturat rajonale të shëndetit publik për përcaktimin e pikave të monitorimit të cilësisë së ujit të pishëm, në përputhje me PSO T003. Marrëveshja duhet të përshkajë:

- Vendndodhjet specifike të pikave të kampionimit.
- Frekuencën e monitorimit.
- Palët përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin.

I mesëm



**UJËSJELLËS
KANALIZIME**
RAJONI DURRËS

Adresa: L.17, Rr. Dalip Përnaj, e-mail: info@ujesjielles.al

Gjetje 11. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm tregon se ndonëse ekzistojnë procedura standarde të operimit (PSO), ndonëse ka një plan të detajuar për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm për çdo skemë furnizimi, mangësjne marrëveshjet zyrtare me strukturat rajonale të shëndetit publik për analiza që duken kryer dhe mënyrën e raportimit.

Rekomandim 11. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime, përmes Departamentit Teknik dhe strukturave përkatëse (Dr.Sh.U / SMCU), duhet të rishikojë dhe forcojë sistemin e kontrollit të brendshëm në fushën e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë së ujit të pijshëm, duke ndërmarrë këto masa konkrete:

11/1. Hartimin e një politike të qartë të kontrollit të brendshëm, me përfshirje të shtesa për:

a. Rregullat zyrtare të komunikimit dhe raportimit të të dhënave;

b. Detyrimin për dokumentim dhe gjurmueslunëri të çdo procedure teknike apo analitike.

11/2. Formalizimin dhe standardizimin e

bashkëpunimit me palët e treta, përmes marrëveshjeve zyrtare me strukturat e shëndetit publik, që lidhen drejtpërdrejt me kontrollin e cilësisë së ujit.

Gjetje 12. Rregullorja e cilësisë së ujit të pijshëm, që udhëzon praktikën e Shoqërisë për monitorimin dhe kontrollin e cilësisë së ujit, është ende e bazuar në VKM nr. 379, datë 25.05.2016, e cila ka pësuar ndryshime me VKM nr. 403, datë 19.06.2024. Për mëtejshje, rregullorja ekzistuese është e papërditësuar dhe mund të përmbajë ulhëzime që nuk përputhen me krahut e ri ligjor në fuqi.

Rekomandim 12. Të rishikohet dhe përditësohet Rregullorja e cilësisë së ujit të pijshëm, duke reflektuar të gjitha ndryshimet e VKM nr. 403, datë 19.06.2024.

12.1. Të njëjtloket dhe legjohet stafi teknik mbi ndryshimet përkatëse.



12.2. Në sigurohet që të gjitha PSO-të dhe adhezionet teknike të përputhen me versionin e ri të rregullores.

Çelësi 13. Në strukturën organizative të impianteve nuk parashikohet dhe nuk është i pranishëm asnjë kinez apo biolog. Aktualisht ekziston vetëm një zëmbës në strukturën e Sektorit të Monitorimit, i cili është përgjegjës për kryerjen e analizave laboratorike për të tre impiantet në laboratorin e Durrësit, duke tejkaluar kapacitetet dhe duke mos siguruar prapinë e vazhdueshme të kontrollit cilësor në vend.

Rekomandim 13: Rishikimi i strukturës organizative të impianteve dhe përfshirja në të e personelit të specializuar sa kimistë dhe biologë rezidentë, të paktën një për çdo impiant, për të siguruar kontrolle të vazhdueshme të cilësisë dhe përputhshmërisë mjedisore. Po ashtu, duhet të rregullohet ndarja funksionale dhe përgjegjësitë ndërmjet Sektorit të Monitorimit dhe personelit të impianteve

GRUPI AUDITIMIT NJAB

Fatmira BAJLIGJINI Drejtuese grupi

Anisa AHMETAJ specialiste auditimi

